



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	03.07.2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPMSH	5000/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.777/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani–Kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.777/2023 të datës 25.05.2023 të parashtruar nga grup ankuesish

kundër

organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.777/2023 e datës 25.05.2023 e parashtruar nga grup ankuesish

A r s y e t i m

Kryesuesi i Këshilli Gjyqësor të Kosovës me datën 23.01.2023 ka marr vendimin me numër KGJK.nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor, në të cilin vendim ankuesit kanë koeficient 5.3, ankuesi i punësuar sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 23.12.2021 në pozitën e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative" në Gjykatën Supreme të Kosovës, ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 18.01.2019 në pozitën e punës "Zyrtar për Teknologji Informative" në Gjykatën Supreme të Kosovës, ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2021 në pozitën e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2021 në pozitën e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative" në Gjykatën Themelore në Prishtinë me koeficient shtatë (7), të njëjtit sipas vendimit të datës 23.01.2023 me numër KGJK.nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor, në paragrafin I pika 16 e tij janë klasifikuar në pozitën Profesional 2 Grupi J Klasa J16 me koeficient 5.3

Ankuesit të pakënaqur me vendimin me numër KGJK.nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor të datës 23.01.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokoll 4412/2023 në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, duke shprehur pa kënaqësi lidhur me klasifikimin në pozitën Profesional 2 Grupi J Klasa J16 me koeficient 5.3 dhe të njëjtit kërkohet që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës të miratoj ankesën e palëve në procedurë dhe të ndryshohet vendimi KGJK.nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor të datës 23.01.2023 ashtu që ankuesve tu njihet koeficienti 10 për TI sikurse institucionet tjera shtetërore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.05.2023 përmes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 14.06.2023 përmes e-mailit, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4412/2023 të datës 25.05.2023 të parashtruar nga ankuesja Vllaznim Makolli grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesë ndaj Vendimit me numër KGJK.01/2023 të datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesë për vërtetim të kërkesës (aktit administrativ) të miratuar në heshtje me numër protokollit nr.03/435 të datës 22.03.2023; Kërkesë e përsëritur për vërtetim të kërkesës (aktit administrativ) të miratuar në heshtje me numër protokollit nr.01/494 të datës 05.04.2023; Vendim për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor me numër KGJK.nr.01/2023 me numër protokollit 01/57 të datës 23.01.2023; Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit i V.M. me Nr.Ref:DS-714/2021 të datës 23.12.2021; Akt Emërim i V.M. i datës 17.08.2017; Akt Emërim i H.M. i datës 18.01.2019; Akt Emërim i L.V. me Nr.Referencës:DS-375/2021 i datës 02.08.2021; Akt Emërim i B.T. me Nr.Referencës:DS-371/2021 i datës 02.08.2021; E-mail nga V.M. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 25.05.2023; E-mail nga L.V. për V.M. i datës 25.05.2023; E-mail nga B.T. për V.M. i datës 25.05.2023; E-mail nga H.M. për V.M. i datës 25.05.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 14.06.2023 përmes e-mailit; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 22.06.2023; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 22.06.2023; Kërkesë për korrigjim të klasifikimit të koeficientit në sistemin gjyqësor sipas Ligjit Nr.08/L-196 dhe Vendimit të KGJK nr. 01/2023 të datës 18 janar 2023 me numër protokollit 03/458 i datës 24.03.2023;

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesve **është e palejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht sipas Akt Emërimit, ankuesi _____ është i punësuar sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 23.12.2021 në pozitën e punës “Zyrtar i Teknologjisë Informative” në Gjykatën Supreme të Kosovës, ankuesi _____ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 18.01.2019 në pozitën e punës ‘Zyrtar për Teknologji Informative’ në Gjykatën Supreme të Kosovës, ankuesi _____ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2021 në pozitën e punës “Zyrtar i Teknologjisë Informative” në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ankuesi _____ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2021 në pozitën e punës “Zyrtar i Teknologjisë Informative” në Gjykatën Themelore në Prishtinë me koeficient shtatë (7), të njëjtit sipas vendimit të datës 23.01.2023 me numër KGJK.nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor, në paragrafin I pika 16 e tij janë klasifikuar në pozitën Profesional 2 Grupi J Klasa J16 me koeficient 5.3

Ankuesit _____ me datë 25.05.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër KGJK.nr.01/2023 të datës 18.01.2023 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me procedimin në sistemin e pagave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Aktgjykimin Ref.Nr.AGJ 1363/19 të datës 20.02.2019 të Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Aktgjykimin KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht duke ju referuar pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ku është përcaktuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dhe pikës 207 po të këtij aktgjykimi ku theksohet se: Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj Personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre”, Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në raport me institucionet e pavarura kushtetuese zbatohen aktet e tyre të brendshme dhe Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për aq sa nuk cenohet pavarësia e tyre.*

Meqenëse për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i njëjti ka përcaktuar organet të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil, konkretisht neni 81 paragrafi 2 i këtij ligji, ka përcaktuar se: *“Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës”,* ndërlidhur me këtë neni 50 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nëpunësit civil kanë të drejtë mbrojtje përmes procedurave të brendshëm administrative ose gjyqësore, si rrjedhojë bazuar në përgjigjen e datës 14.06.2023 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës, ka gjetur se ankuesit nuk kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të njëjtit është dashur së pari të parashtronjë ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet në nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”,* pastaj në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke u bazuar në nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative kanë mundur të ushtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e nenit 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit...”* dhe nenit 3 paragrafit 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Para parashtrimin të ankesës në Këshill, ankueset duhet t’i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit...”*, Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankuesve



e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura dhe si i tillë është e para afatshme.


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.777/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

